

PROGRAM ME KARAKTER PROFESIONAL NË “LIBRAR DHE BIBLIOTEKAR”

Emërtimi akademik i studimit	Diplomë Profesionale në “LIBRAR DHE BIBLIOTEKAR”
Statusi i Akreditimit të programit të studimit	Në proces akreditimi
Cikli i studimit	Studime me karakter profesional
Emri dhe statusi i institucionit	Universiteti “Eqrem Çabej”, Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Njësia bazë e Gjuhës shqipe dhe Letërsisë; institucion publik, i akredituar
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit	2 (dy) vjet
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kriteret e pranimit	a. Pranimi i studentëve në programet me karakter profesional, është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm të përgjithshëm apo profesional. b. Në këtë program studimi nota mesatare nuk është kriter pranimi. c. Renditja e kandidatëve fitues kryhet sipas rendit zbritës të notës së tyre mesatare deri në plotësimin e kuotave të shpallura. d. Pranimi i studentëve për këtë program studimi kryhet nëpërmjet Maturës Shtetërore (portali U-albania).

OBJEKTIVAT DHE VEPRIMTARITË FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi i programit “**Librar dhe Bibliotekar**” është të aftësojë dhe të pajisë studentët me njohuri të duhura për t’u përgatitur si punonjës të bibliotekave dhe të arkivave të institucioneve publike dhe jopublike. Gjithë procesi akademik udhëhiqet nga disa objektiva të përcaktuara qartë, duke synuar që studentët në fund të ciklit të studimit:

1. Të kenë njohuri mbi historinë e letërsisë shqipe dhe historinë e letërsisë së huaj për një formim profesional të librarit dhe bibliotekarit.
2. Të zotërojnë njohuri për shkrimin e shqipes.
3. Të kenë njohuri për interpretimin dhe orientimin në katalogët dhe bibliografitë e botimeve.
4. Të kenë njohuri mbi etnokulturën që ka lënë gjurmë në zhvillimet e shoqërisë njerëzore.
5. Të kenë njohuri mbi historinë e shtypit dhe periodikëve.
6. Të kenë njohuri për mënyrat e komunikimit, punës në grup dhe mirësjelljes bazuar te “Kodi i Etikës së librarit dhe bibliotekarit”.
7. Të kenë njohuri mbi organizimin dhe legjislacionin në fushën e bibliotekave dhe të botimit.

8. Të kenë njohuri mbi TIK-un (teknologjinë e informacionit dhe komunikimit) në fushën e bibliotekave dhe të botimit.
9. Të zotërojnë njohuri të thelluara në gjuhën angleze, franceze dhe italiane, në përgjithësi dhe atë të profesionit, në veçanti, për të qenë të aftë të komunikojnë, si dhe të përdorin gjuhën e folur dhe të shkruar në komunikim.

Figura profesionale bazë që formohet nëpërmjet këtij programi është ajo specialistit të bibliotekës, arkivës, menaxherit të shit-blerjeve të librave, punonjës i shtypshkronjës, asistent/sekretar në institucione të ndryshme, punonjës në radio dhe televizione, si dhe punonjës në administratë për kulturën.

Objektivat e përmendura më lart dhe të tjera aftësi, si: menaxhuese, organizuese, interpretuese, promovuese që ky program synon të arrijë me studentët që ndjekin këtë cikël studimi, do të sigurojnë një performancë sa më të lartë në mjedisin publik apo privat, në të cilin do të veprojnë si të punësuar në të ardhmen.

Për realizimin e këtyre objektivave, programi parashikon thellime në fusha të tilla si ato të: arkivistikës, skedimit dhe katalogimit, etikës së komunikimit, bibliografisë së botimeve, të gramatikës, të letërsisë etj.

VEPRIMTARITË FORMUESE

1. **Lëndë bazë:** Njohuri mbi historinë e letërsisë shqipe; Njohuri mbi historinë e gjuhës; Njohuri mbi letërsinë botërore (viti i parë). **Kredite 18 (tetëmbëdhjetë).**
2. **Lëndë karakterizuese:** Shkrimi i shqipes; Tipologji teksti; Morfologji e gjuhës shqipe; Bibliografi e botimeve (viti i parë). Etnokultura shqiptare; Arkivistikë; Skedim katalogim; Pragmatikë; Histori shtypi dhe periodikë; Sintaksë (viti i dytë). **Kredite 64 (gjashtëdhjetë e katër).**
3. **Lëndë integruese:** Onomastikë; Etnolinguistikë (viti i parë). Kulturë gjuhe (viti i dytë). **Kredite 12 (dymbëdhjetë).**
4. **Lëndë me zgjedhje:** Etikë komunikimi; Histori, kulturë dhe qytetërim; Hartim dhe menaxhim projekti (viti i dytë). **Kredite 6 (gjashtë).**
5. **Lëndë plotësuese:** Shprehi gjuhësore dhe teknologji informacioni (viti i parë). Praktikë mësimore profesionale (viti i dytë). **Kredite 16 (gjashtëmbëdhjetë).**
6. Provim i përgjithshëm përfundimtar ose punimdiplome. **Kredite 4 (katër).**

SKEMA E VLERËSIMIT

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem notash nga 1 deri në 10, ku notat kanë kuptimin e mëposhtëm : 1-4 (mbetës), 5 (mjaftueshëm), 6 (kënaqshëm), 7-8 (mirë), 9 (shumë mirë), 10 (shkëlqyer).

Gjatë provimit aplikohet një sistem pikësh, rezultatet e të cilave konvertohen në nota bazuar në skemën e mëposhtme:

NOTA	PIKËT
4 (katër)	0 në 44 pikë
5 (pesë)	45 - 54 pikë
6 (gjashtë)	55 - 64 pikë
7 (shtatë)	65 - 74 pikë
8 (tetë)	75 – 84 pikë
9 (nëntë)	85 – 94 pikë
10 (dhjetë)	95 – 100 pikë

MUNDËSIA PËR RRRITJE TË MËTEJSHME PROFESIONALE

Diploma juaj e studimeve me karakter profesional “Librar dhe Bibliotekar” është e lidhëse e zhvillimit të mëtejshëm profesional drejt arritjes së qëllimit. Kurrikula jonë e ndërtuar mbi konceptet bazë të mësimdhënies e mësimnxënies, sipas kornizës kurrikulare kombëtare, është e hartuar në mënyrë të tillë që të ofrojë formate të përshtatshme të të mësuarit, të përvetësuarit dhe zgjerimit të njohurive të mëtejshme. Prandaj, detyra jonë më e rëndësishme është përgatitja e studentëve për sfidat dhe mundësitë që ofron ky program studimi.

Studenti, i cili diplomohet në programin e studimit me karakter profesional në “Librar dhe Bibliotekar”, fiton të drejtën të punësohet si botues, specialist i bibliotekave, punonjës i bibliotekave të njëjësive bashkiake, të bibliotekave të shkollave, punonjës i radiove dhe televizioneve, punonjës kulture etj.

Vetëm pas mbarimit të këtij cikli studimi, studentëve do t’u hapen mundësitë për punësim më të sigurt në institucionet përkatëse.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT DHE KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

Gjithnjë e më shumë tregu i punës po kërkon specialistë /ekspertë të kualifikuar me njohuri të tilla si: asistent kulture në institucione të ndryshme, punonjës në radio dhe televizion, arkivist, organizues, menaxhues, promovues. Për këtë arsye, synimi i programit të studimit me karakter profesional në “Librar dhe Bibliotekar” është përgatitja e të diplomuarve të cilët do të plotësojnë kërkesat në rritje për këto pozicione që i kërkon tregu i punës.

Në këtë mënyrë, këta të diplomuar mund të punësohen në:

1. Shtëpi të ndryshme botuese.
2. Në qendrat e shit-blerjeve të librave.
3. Në bibliotekat e qytetit dhe të shkollave.
4. Në radio dhe televizione.
5. Punonjës në administratë për kulturën.

Studentët të cilët përfundojnë programin e studimit me karakter profesional në “Librar dhe Bibliotekar”, fitojnë njohuri, si: specialistitë të bibliotekës, arkivës, menaxherit të shit-blerjeve të librave, punonjës të shtypshkronjës, asistent/sekretar në institucione të ndryshme, punonjës në radio dhe televizione, si dhe punonjës në administratë për kulturën.

DETAJET E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithsej	Semestri
Viti i parë				
1.	Njohuri mbi historinë e letërsisë shqipe	6	150	I
2.	Njohuri mbi historinë e gjuhës	6	150	I
3.	Njohuri mbi letërsinë botërore	6	150	I
4.	Shkrimi i shqipes	8	200	II
5.	Tipologji teksti	8	200	II
6.	Morfologji e gjuhës shqipe	7	175	II
7.	Bibliografi e botimeve	7	175	II
8.	Shprehi gjuhësore dhe teknologji informacioni	6	150	I
Lëndë me zgjedhje				
9.	Onomastikë	6	150	I
	Etnolinguistikë			
Gjithsej viti i parë		60 ECTS	1500 orë	

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithsej	Semestri
Viti i dytë				
1.	Etnokultura shqiptare	6	150	I
2.	Arkivistikë	5	125	II
3.	Skedim katalogim	5	125	II
4.	Pragmatikë	6	150	I
5.	Histori shtypi dhe periodikë	6	150	I
6.	Sintaksë	6	150	I
7.	Kulturë gjuhe	6	150	I
Lëndë me zgjedhje				
8.	• Etikë komunikimi	6	150	II
	• Histori, kulturë dhe qytetërim			
	• Hartim dhe menaxhim projekti			
9.	Praktikë mësimore profesionale	10	250	II
10.	Provim i përgjithshëm përfundimtar ose punimdiplome	4	100	II
Gjithsej viti i dytë		60 ECTS	1500 orë	